



Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

GJIMNAZI „17 SHKURTI”

Protokoli:206

Dt.16/09/2024

FTESË PËR OFERTË

GJIMNAZI „17 SHKURTI”-Obiliq organizon ekskursion 4 buajtje , 5 ditë për në Shqipëri për 97 nxënës të klasëve maturantë

Ekskursioni planifikohet të realizohet prej datës 03.10.2024 deri me 07.10.2024.me këtë itinerar:

- Dita e parë, Obiliq- Prizren -Krujë- Durrës(vendosja ne hotel)
- Dita e dytë, Durrës- Berat
- Dita e tretë, Durrës- Vlorë (Shtëpia e Pavarësisë, Monumentet Historike)
- Dita e katërt, Durrës - Tiranë - (Durrësi i vjetër)
- Dita e pestë, Durrës- Lezhë (vizitë varrit të Skënderbeut), Shkodër nisja për Kosovë .

Oferta duhet të përfshijë vetëm itinerarin e paraqitur më lartë dhe duhet të përfshihet vetëm një çmim, në të kundërtën oferta nuk do të merret në konsiderat nga komisioni.

Në ofertë duhet të paraqitet itinerari, çmimi për nxënës, hoteli, racionet dhe menyuja e ushqimit.

Të drejtë pjesmarrje në ofertë kanë të gjitha agjencionet që plotësojnë këto kushte të përgjithshme :

- Licencën e Agjencionit (turizëm ndërkombtar)
- Certifikatë e biznesit dhe informatori kompanise
- Numri fiskal
- Vërtetim i ATK-së që kompania nuk ka obligime tatimore
- Referenca për punët e kryera në lidhje me këtë veprimtari (të ketë referenc pozitive)
- T'i ketë dëshmi me afat që ka kryer procedurat e kontrollimit teknik (dëshmi me shkrim).
- Numrin e mjaftueshëm të Autobusëve (të ketë dëshmi)
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore të shoferëve të autobusëve
- Kontratat e punës dhe vërtetimin e ATK-së për vozitës.
- Autobusët duhet të janë komfor dhe me klimë.
- Të siguroj përkujdesje mjekësore (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut).

Dorëzimi: Oferta e përpiluar në formë të kërkuar duhet të vendoset në pliko të mbyllur dhe të vulosur nga ana e ofertuesit, si dhe të shkruhet qartë Oferta për Ekskursion për maturantët e GJIMNAZIT „17 SHKURTI”-Obiliq.

Ofertat dorëzohen në Drejtorin e Arsimit në Obiliq prej dt: 23/09/2024 deri më dt.: 27/09/2024 në ora 10.00.

Hapja e ofertave : Hapja e ofertave do të bëhet më dt.: 27/09/2024 në ora 13:30 në Drejtorinë e Arsimit në Obiliq.

UD.Drejtores: MSc.Besa Gashi Dvorani

